



Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tiranë – E hënë, 18 maj 2015

PËRMBAJTJA

Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 5848, datë 17.4.2015	Për shitje.....	3
Njoftim i Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë nr. 2960, datë 13.5.2015	Kërkesë për shprehje interesi për shërbime konsulence.....	5
Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 7296, datë 14.5.2015	Për shitje.....	9
Njoftim i Ministrisë së Financave nr. 7308, datë 14.5.2015	Për shitje.....	17
Vendim i Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, nr. 42011-00861 958 datë 16.4.2014	Me objekt deklarinimin e fillimit të procedurave të falimentimit për riorganizimin e shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.....	19
Vendim i Gjykatës së Apelit Durrës nr. 10-2015-588148 datë 12.3.2015	Me objekt deklarinimin e fillimit të procedurave të falimentimit për riorganizimin e shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.....	24



NJOFTIM I MINISTRISË SË FINANCAVE
Nr. 5848, datë 17.4.2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", kapitulli III, pika 2, germa "c", shpall për shitje objektet si më poshtë:

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)				Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)
			Vlera fillestare e shitjes (Mjete kryesore + mjete xhiro)	Mjetet kryesore	Mjetet e xhiro	Trualli		
1	"Depo"	Libonik, Korçë	44 018 754.05	44 018 754.05	0	920 612.05	3 917.5	2 254.32

Subjekti i shpronësuar i truallit, mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë brenda afatit të publikimit pranë Ministrisë së Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
- Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.
- Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.
- Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimit etj., nëse ka të tilla.
- Deklaratë notoriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të publikimit. Mandatpagesa apo garancia bankare apo mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të keni tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Shënim. Publikimi bëhet për ish-pronarët e truallit trashëgimtarët BAME DHE GURI
Afati i publikimit fillon më datë 20.4.2015 dhe mbaron më datë 19.5.2015.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", kapitulli III, pika 2, germa "c", shpall për shitje objektet si më poshtë:

1. Në pronësi të bashkisë Shkodër

Nr.	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)				Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)
			Vlera fillestare e shitjes (Mjete kryesore + mjete xhiro)	Mjetet kryesore	Mjetet e xhiros	Trualli		
1	"Ish-Dogana Stacioni i Trenit"	Shkodër	13 735 898	13 735 898	0	8 882 500	1 045	1 045

Subjekti i shpronësuar i truallit, mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja, duhet të paraqesë brenda afatit të publikimit pranë Ministrisë së Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike, dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
- Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.
- Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.
- Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.
- Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfutur kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish-Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të publikimit. Mandatpagesa apo garancia bankare apo mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të keni tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Shënim. Publikimi bëhet për ish-pronarët e truallit trashëgimtarët e Gjin Leke KOQEKU

Afati i publikimit fillon më datë 20.4.2015 dhe mbaron më datë 19.5.2015.



NJOFTIM I MINISTRISË SË MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

PROJEKTI I MODERNIZIMIT TË ASISTENCËS SOCIALE (SAMP) KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

SHËRBIME KONSULENCE PËR

“Hartimi i procedurave të biznesit dhe marrëveshjet institucionale (p.sh. përbërja dhe funksionimi i komisionit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar), përfshirë planin e veprimit dhe çdo rishikim të nevojshëm të kuadrit ligjor sipas Modelit Social”- Ref. no.SAMP/CS/CQ/03-2014

Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale - (SAMP)

Hua no.: 8141- AL

Nr. i identifikimit të Projektit. P122233

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP), dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (Shërbim) përfshin “Hartimi i procedurave të biznesit dhe marrëveshjet institucionale (p.sh. përbërja dhe funksionimi i komisionit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar), përfshirë planin e veprimit dhe çdo rishikim të nevojshëm të kuadrit ligjor sipas Modelit Social”.

Në kuadrin e reformës për aftësinë e kufizuar, MMSR-së i është propozuar një model i ri për vlerësimin dhe administrimin e programit të aftësisë së kufizuar së bashku me një plan mbështetës individual. Bazuar në këtë propozim një dokument i politikave për zbatimin e modelit të ri të vlerësimit dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar është duke u përgatitur dhe pritet të miratohet së shpejti nga ana e zyrtarëve të lartë të Ministrisë. Me përshtatjen dhe miratimin e këtij dokumenti, Ministria do të fillojë zhvillimin e planit përkatës të veprimit, së bashku me përllogaritjen e një kosto financiare të nevojshme për zbatimin e tij. Në bazë të dy dokumenteve të rëndësishme për zbatimin e modelit të ri (dokumentit të politikave dhe planit të veprimit), do të përgatitet kuadri përkatës ligjor dhe administrativ i cili mbështet ndryshimet e propozuara në vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar. Në këtë kontekst, disa prej akteve ekzistuese legjislative/ligje do të duhet të

shfuqizohet dhe një paketë të re legjislative do të duhet të miratohet për trajtimin në mënyrë të barabartë të të gjithë personave me aftësi të kufizuara, caktimin e pagesave të tyre bazuar tashmë në kriteret funksionale dhe jo mbi statutet e tyre.

Në këtë kontekst MMSR do të rekrutojë një kompani lokale me njohuri të forta dhe ekspertizë në fushat sociale, ligjore dhe financiare për të ndihmuar në:

- Zhvillimin e një plani veprimi për zbatimin e modelit të ri për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar në bazë të dokumentit të miratuar të politikave.

- Llogaritja e detajuar e kostove të nevojshme për zbatimin e skemës së re të propozuar dhe miratuar dhe analiza krahasuese me koston e skemës ekzistuese.

- Zhvillimi i strategjisë së komunikimit, së bashku me aktivitetet e fushatës dhe koston e vlerësuar.

- Përgatitja e dokumentacionit përfundimtar ligjor/nënligjor, të nevojshëm për zbatimin e fazës pilot të modelit të ri të propozuar dhe miratuar në bazë të materialeve të përgatitura nga dy ekspertë të aftësisë së kufizuar të projektit SAMP.

- Përgatitja e ligjeve/rregulloreve për të bërë ndërhyrjet e nevojshme në legjislacionin ekzistues dhe përgatitjen e paketës së re ligjore për zbatimin e modelit të ri në bazë të materialeve të përgatitura nga dy ekspertë të aftësisë së kufizuar të projektit SAMP.

- Draftimin e dokumentacionit përfundimtar ligjor për funksionimin e administratës së re të vlerësimit, si dhe marrëveshjet ndërinstitucionale në bazë të dokumenteve të përgatitura nga dy ekspertë të aftësisë së kufizuar të projektit SAMP.

Ky shërbim kërkon një ekip të përbërë nga një ekspert social me përvojë të gjerë në fushën e aftësisë së kufizuar, një ekspert ligjor me përvojë në analizën dhe përgatitjen e kuadrit ligjor dhe një ekspert finance me përvojë në të analizës dhe vlerësimit kosto shërbimeve / programeve në nivel kombëtar.



Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT) fton të gjithë kompanitë konsulente të pranueshme (Konsulente) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë informacion që të demonstrojnë se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimet. Kriteret e shortlistimit dhe të vlerësimit janë:

1. Eksperienca e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e shërbimit - 10 pikë
 2. Numri i shërbimeve/kontratave të kryera gjatë tre viteve të fundit - 10 pikë
 3. Eksperienca e Përgjithshme dhe kualifikimi i eksperteve kryesorë - 30 pikë
 4. Eksperienca dhe kualifikime të ngjashme me këtë shërbim të stafit kryesor - 40 pikë
 5. Numri i viteve të personelit kryesorë në firmë - 10 pikë
- TOTAL 100 pikë

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në paragrafin 1.9 të udhëzuesve të Bankës Botërore për: Përzgjedhja dhe Punësimi i Konsulentëve nga kredi të IBRD dhe hua të IDA & Grante nga Huamarrësit e Bankës Botërore (Udhëzuesi i Konsulencës)- version i janarit të 2011.

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera në formën e një “*joint venture*” apo në formën e nënkontraktimit për të forcuar kualifikimet e tyre.

Konsulenti duhet të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është “Përzgjedhje sipas kualifikimit të konsulentit” – CQ, në përputhje me procedurat e udhëzuesve të Bankës Botërore për përzgjedhjen e punësimit e konsulentëve (botimi janar 2011).

Konsulenti pritët të fillojë shërbimin në korrik 2015 dhe ta përfundojë atë në mars 2016.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00 - 16:00 (e hënë deri të enjten) dhe 08:00 -14:00 të premtën.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi, ose me e-mail) deri në 27 maj 2015.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)
Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë – kati 1

Rr: “Kavajës”, nr.53, Tërana, ALBANIA
Në vëmendje të: znj. Suzana Papadhopulli
e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com
Në vëmendje të: znj. Elma Dogani
e-mail: samp.dogani@gmail.com



PROJEKTI I MODERNIZIMIT TË ASISTENCË SOCIALE (SAMP)
REQUEST FOR EXPRESSION OF INTEREST

CONSULTING SERVICES
FOR

“Design business procedures and institutional arrangements (e.g. composition as well as functioning of disability evaluation commission) including action plan and any required revision of legal framework as necessitated by the

Social Model” - Ref. no. SAMP/CS/CQ/03-2014

Albania

Social Assistance Modernization Project - (SAMP)

Loan No.: 8141- AL

Project ID No. P122233

The Republic of Albania, has received financing from the World Bank toward the cost of the Social Assistance Modernization Project (SAMP), and intends to apply part of the proceeds for consultant services. The consulting services (“the Services”) include “Design business procedures and institutional arrangements (e.g. composition as well as functioning of disability evaluation commission) including action plan and any required revision of legal framework as necessitated by the Social Model”.

In the frame of the disability reform a new model for the assessment and administration of disability along with an individual support plan process is proposed to the MSWY. Based on this proposal a policy paper for the implementation of the new model of evaluation and definition of disability is being prepared and it is expected to be approved soon by the senior officials of the Ministry. With the adoption of this document the Ministry will start the development of the respective action plan along with a financial cost necessary for its implementation. On the basis of two important documents for the implementation of the new model, policy paper and action plan, the respective legal and administrative framework which supports the proposed changes in the assessment and determination of disability will be prepared. In this contest some of existing legislative acts/laws will need to be repealed and a new legislative

package will need to be adopted for treating equally all persons with disabilities, allocating their payments based in functional criteria and not on their statuses.

In this context MoSWY will recruit a local company with strong knowledge and expertise in the social, legal and financial fields to assist in:

- Development of an action plan for implementation of the new model for the assessment and determination of disability on the basis of the approved policy paper.

- The detailed calculation of costs necessary for the implementation of the proposed and approved new scheme and comparative analysis of the cost of the existing scheme.

- Development of the communication strategy, along with campaign activities and estimated costs.

- Preparation of final legal/sublegal documentation, necessary for the implementation of the pilot phase of the proposed and approved new model on the basis of materials prepared by two disability experts of SAMP project.

- Preparation of laws / regulations to make the necessary interventions in existing legislation and preparing new legal package for the implementation of the new model on the basis of materials prepared by two disability experts of SAMP project.

- Drafting of final legal documentation for the operation of the new administration of the assessment as well as inter-institutional arrangements on the basis of documents prepared by two disability experts of SAMP project.

This service requires a team consisting of a social expert with wide experience in the disability field, a legal expert with experience in the analysis and preparation of the legal framework and a finance expert with experience in analysis and cost estimation services / programs at national level.

The Project Management Team now invites eligible consulting firms (“Consultants”) to indicate their interest in providing the Services. Interested Consultants should provide



information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services.

The short listing criteria are as below:

1. Overall experience of the firm (number of years) in the field of assignment- 10 points
2. Number of assignment-related contracts completed during last three years – 10 points
3. General experience and qualification of the key personnel- 30 points
4. Assignment-relevant experience and qualification of key personnel – 40 points
5. Number of years of the key personnel in the firm – 10 points

TOTAL 100 points

The attention of interested Consultants is drawn to paragraph 1.9 of the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants under IBRD Loans and IDA Credits & Grants by World Bank Borrowers ("Consultant Guidelines")- January 2011 , setting forth the World Bank's policy on conflict of interest.

Consultants may associate with other firms in the form of a joint venture or a sub consultancy to enhance their qualifications.

The consultant should be a Local Firm. The selection method to be applied is Consultants Qualification Selection (CQ), in accordance with the procedures set out the World Bank's Guidelines: Selection and Employment of Consultants by World Bank Borrowers (edition of 2011).

The consultant is expected to start the service on July 2015 and to complete it by March 2016.

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday.

Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by fax, or by e-mail) by May 27, 2015.

Project Management Team (PMT)
Social Assistance Modernization Project (samp)
Ministry of Social Welfare and Youth – 1-st floor

Rr: "Kavajes", Nr.53, Tirana, ALBANIA

Att: Suzana Papadhopulli

e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com

Att: Elma Dogani

e-mail: samp.dogani@gmail.com



NJOFTIM I MINISTRISË SË FINANCAVE
Nr. 7296, datë 14.5.2015



REPUBLIKA E SHQIPËRIË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", shpall për shitje me VAM fillestar si më poshtë:

SHOQËRITË HUAMARRËSE, ADMINISTRATORI

1. Pronësi të shoqërisë "Kamberi"

Nr	Emërtimi	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Njësi Tregtare	Lagja Kushtrimi, Rr Rakp Malile, Vlore	6 449 520	6 449 520		42	42	09.06.2015	08.00	DDPP
2	Ish-Pularia	Fshati Grize, Patos, Fier	21 600 000			1375	372	09.06.2015	08.30	DDPP

2. Në pronësi të VEFA sh.p.k. në administrim

Nr	Emërtimi	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit objekti + trualli	Mjetet kryesore objekti	Trualli			Data	Ora	Vendi
1.	Apartament banimi 2+1 Nr. pasurie 15/54+3-8	Lagja 24 Maji, rruga e re, tek Kisha, Vlorë	3 600 000	3 600 000		86	86	09.06.2015	09.00	DDPP



Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.
3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandat pagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandat-pagesa apo garancia bankare apo mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të keni tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E FINANCAVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", shpall për shitje me ulje VAM-i si më poshtë:

1. Në administrim të komunës Potom, Skrapar

Nr	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Dyqan Industrial	Potom, Skrapar	480 017	465 385	14 632	124	124	09.06.2015	09.30	DDPP

2. Në administrim të Drejtorisë Rajonale e Rrugëve Shkodër

Nr	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Ndërtese e Grupit Qafë-Qele	Qafe-Qele	64 156	58 716	5 440	40	40	09.06.2015	10.00	DDPP

3. Në administrim të Drejtorisë Rajonale e Rrugëve Shkodër

Nr	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Ndërtese e Grupit Bogë	Bogë, Shkodër	1 144 495	1 129 177	15 318	66.6	66.6	09.06.2015	10.30	DDPP



4. Në administrim të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes

Nr	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1.	Banaku i Lokal Sopotit	Librazhd	1 289 120	1 190 000	99 120	40	40	09.06.2015	11.00	DDPP

5. Në administrim të Ministrisë së Punëve të Brendshme

Nr	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	“Fjetine” dhe “Mence e kuzhine”, te Postes se Policisë Kufitare Llongo	Gjirokastrë	4 990 733.5	4 723 533.5	267 200	800	383	09.06.2015	11.30	DDPP

6. Në administrim të Shpërndarja e Librit Shkollor” sh.a. në likuidim

Nr	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Librari	Sinanaj, Tepelene	124 665	109 705	14 960	88	67	09.06.2015	12.00	DDPP

1. Në administrim të Ministrisë së Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

Nr	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	“Depo drithi”, “Depo drithi pranë peshores”	Trebinje, Pogradec	7 149 425.1	6 800 147.5	349 277.6	1800.4	809.85	09.06.2015	12.30	DDPP



Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.
3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.
3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.
4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.
5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish- Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandat pagesa apo Garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandat pagesa apo Garancia bankare apo mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të keni tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014 "Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes", shpall për shitje me VAM fillestar si më poshtë:

1. Në administrim të Bashkisë Fushë-Krujë

Nr	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Objekt ndërtimor i ish-kooperativës bujqësore "Partizani"	Fushë-Krujë	1 137 500	1 088 587.5	48 912.5	17.5	17.5	09.06.2015	13.00	DDPP

2. Në administrim të Bashkisë Gramsh

Nr	Emërtimi i objektit	Vendndodhja	Vlerat (në lekë)			Sipërfaqja e përgjithshme (m ²)	Sipërfaqja nën objekt (m ²)	Zhvillimi i ankandit		
			Vlera fillestare e ankandit (Mjete kryesore + trualli)	Mjetet kryesore	Trualli			Data	Ora	Vendi
1	Ish-zdrukthëtari për shërbime funerale	Gramsh	734 978	462 398	272 580	110	84	09.06.2015	13.30	DDPP



Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** në origjinal që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.
3. **Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësi në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20 % e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Subjekti i shpronësuar i truallit mbi të cilin ndodhet objekti apo ndërmarrja duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

1. **Kërkesë me shkrim** për blerjen e objektit apo ndërmarrjes e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
2. **Mandatpagesën apo garancinë bankare** që vërteton ngurtësimin e 20 për qind të vlerës fillestare në lekë, vetëm për objektin (Mjete kryesore), për llogari të Ministrisë së Financave në Drejtorinë e Drejtimit të Pronës Publike, detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave.
3. **Vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave**, të shoqëruar me planvendosjen e pronës, ku përcaktohet se ai është subjekt pronar i tokës.
4. **Dëshminë e trashëgimisë**, prokurë përfaqësimi etj. nëse ka të tilla.
5. **Deklaratë noteriale**, në të cilën trashëgimtarët e subjektit të shpronësuar që kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e parablerjes për objektin në proces privatizimi, të deklarojnë se, që nga momenti që janë pajisur me vendimin e Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, nuk kanë përfituar kompensim në asnjë nga format e parashikuara në ligj. Gjithashtu, të deklarojnë se vendimi i ish- Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ose i Agjencisë së Kthimit dhe Kompensimit të Pronave nuk ka ndryshuar ose është shfuqizuar me ndonjë akt administrativ apo vendim të formës së prerë.

Mandat pagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandat pagesa apo Garancia bankare apo mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të keni tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E FINANCAVE

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE**

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave 926, datë 29.12.2014 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe procedurën e shitjes”, i ndryshuar, shpall për shitje me VAM të ulur si më poshtë:

1. Në administrim të Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë, Tiranë

Nr	Emërtimi	Datëlindja	Vendndodhja	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
					Data	Ora	Vendi
1	Qeni "Beli"	24.02.2007	Tiranë	5 600	09.06.2015	14.00	DDPP
2	Qeni "Xheku"	06.03.2008	Tiranë	5 600	09.06.2015	14.30	DDPP
3	Qeni "Noksi"	13.09.2005	Tiranë	5 600	09.06.2015	15.00	DDPP
4	Qeni "Iaza"	30.03.2007	Tiranë	5 600	09.06.2015	15.30	DDPP
5	Qeni "Sota"	07.12.2009	Tiranë	5 600	09.06.2015	16.00	DDPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit dokumentacionin si më poshtë:

- Kërkesë me shkrim** për blerje e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Financave.
- Garancinë bankare apo mandatpagesën** në origjinal që vërteton ngurtësimin e 20 % të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë për llogari të Ministrisë së Financave.
- Dokument identifikimi** (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën shpallur për shitje, i konfiskohet 20 % e garancisë bankare, e ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Garancia bankare apo mandat pagesa duhet të bëhet detyrimisht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Garancia bankare apo mandat pagesa mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Ministrinë e Financave pasi të kenë tërhequr pranë DDPP ose degëve të thesarit në rrethe faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Financave www.financa.gov.al



NJOFTIM I MINISTRISË SË FINANCAVE
Nr. 7308, datë 14.5.2015



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
 MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORIA E DREJTIMIT TË PRONËS PUBLIKE

Njofton:

Mbështetur në vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 832, datë 03.12.2014, “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare, që veprojnë në sektorët jostrategjikë” dhe në urdhrin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes nr. 382, datë 24.07.2014, shpall për shitje me ankand paketën shtetërore të aksioneve të shoqërisë si më poshtë:

Emri i shoqërisë	Selia	Kapitali themeltar (lekë)	Numri i aksioneve	Paketa e aksioneve që privatizohet (në %)	Vlera e paketës që privatizohet në lekë	Objekti i veprimtarisë	Sipërfaqja e truallit të shoqërisë në m ²	Zhvillimi i ankandit		Vendi i zhvillimit të ankandit
								Data	Ora	
Buka sh.a. Tiranë	Tiranë	239 000 000	130 163	45.977	338 345 876	Prodhim dhe shitjen e bukës të të gjitha llojeve, të majasë së bukës dhe produkte të tjera nga përpunimi i miellrave. Zhvillon aktivitet ndihmës për nevojat e prodhimit për të tretë. Shoqëria zhvillon aktivitet import – eksporti dhe biznesi për rritjen e të ardhurave, si dhe jep me qira objekte të lira.	39 020	18.06.2015	10.00	Ministria e Financave Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike



Të gjithë personat fizikë ose juridikë të interesuar për blerjen e paketës së aksioneve të kapitalit të zotëruar nga shteti në këtë shoqëri duhet të paraqiten në datën, orën dhe vendin e zhvillimit të ankandit të shënuar më sipër,

Sa vijon:

- Kërkesën me shkrim për pjesëmarrjen në ankand për privatizimin e paketës së aksioneve të shoqërisë;
- Dokumentet ligjore, identifikuese të personave fizikë ose juridikë (certifikatën e regjistrimit në QKR, historikun në QKR, NIPT);
- Dokumentin bankar të pagesës paraprake me lekë, mandate arkëtimi, urdhërshirimi apo garancinë bankare (vetëm nga bankat) për 30% të vlerës së paketës së aksioneve të publikuar në lekë, në favor të Drejtorisë së Drejtimit të Pronës Publike;

Shënim

Të gjithë personat fizikë dhe juridikë të interesuar, gjatë periudhës së publikimit mund të njihen me dosjen e shoqërisë në Ministrinë e Financave, Drejtoria e Drejtimit të Pronës Publike dhe mund të marrin informacionin pranë shoqërisë që privatizohet.

Paraqitja e personave fizikë dhe juridikë që nuk plotësojnë kriteret e mësipërme nuk merret në konsideratë.



VENDIM

Nr. 42011-00861, datë 16.4.2014

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, e përbërë prej:

Kryetari i seancës gjyqësore: Petraq Çuri

Asistuar prej sekretares Diana Medani, sot më datë 16.6.2014, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, çështjen civile që i përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k. me nr. NUIS J92406502S, me seli në Durrës, L.17, pranë Tregut Industrial, me administrator Andi Koça e Artan Ziu, përfaqësuar me deklaram dhe me autorizim datë 12.3.2014 nga av. Artion Beqiri me nr. licence 2294, i Dhomës së Avokatisë Durrës.

PERSONA TË TRETË: 1. Qendra Kombëtare e Regjistrimit Tiranë, në mungesë.

2. Zyra Vendore e Regjistrimit Tiranë, në mungesë.

3. Enkelejda Ziu e bija e Miço dhe e Haretisë, e datëlindjes 13.9.1973, lindur e banuese në Durrës, L.1, Rr. “Taulantia”, nr. 1008, në mungesë

4. Drejtoria e Tatim-Taksave Bashkia Durrës, përfaqësuar me autorizimin e datës 24.4.2014 nga Arsentia Lika, në mungesë.

5. Drejtoria Rajonale e Tatim-Taksave Durrës, përfaqësuar me autorizimin nr. 8624 prot., datë 5.5.2014 nga Elvin Shllaku, në mungesë.

6. Banka Kombëtare e Greqisë, përfaqësuar nga Ermira Lahi dhe Oligerta Kasneci.

7. Raiffeissen Bank përfaqësuar nga Edison Arizaj dhe Arbër Ademi me autorizimin datë 24.4.2014.

8. Procredit Bank përfaqësuar nga Ergys Sinani me autorizimin me nr. TH- 1613, datë 23.4.2014, në mungesë

9. “CEZ Shpërndarje” sh.a. Durrës, në mungesë.

10. Kompania Celulare “Vodafone” sh.a. në mungesë.

OBJEKTI: 1. Deklarimin e fillimit të procedurave të falimentit për riorganizimin e shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

2. Marrja e masës së sigurimit, duke vendosur:

a) Kufizim të veprimeve pranë ZVRPP Durrës, DPSHTRR sh.a. QKR mbi pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, si dhe kuotave të

shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k., moslejimin e tjetërsimit ose rendimin me detyrime të këtyre pasurive dhe të kuotave deri në përfundimin e shqyrtimit të kërkesës.

b) Pezullimin e përkohshëm të masave të sigurisë dhe ekzekutimit të një të drejte të siguruar.

c) Caktimin e administratorit të përkohshëm të falimentit.

BAZA LIGJORE: Neni 334 e vijues i KPC-së. Nenet 2, 3, 4, 11/1, 13, 14/1, 15, 18, 21, 180, 181/1 e vijues të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar.

Gjykata, pasi administroi provat, dëgjoi palën kërkuese, që kërkoi pranimin e kërkesës, personat e tretë,

VËREN:

Kërkuësja, shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt:

1. Deklarimin e fillimit të procedurave të falimentit për riorganizimin e shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

2. Marrjen e masës së sigurimit, duke vendosur:

a) kufizim të veprimeve pranë ZVRPP Durrës, DPSHTRR dhe QKR mbi pasuritë e luajtshme e të paluajtshme, si dhe kuotave të shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k., moslejimin e tjetërsimit ose rendimin me detyrime të këtyre pasurive dhe të kuotave deri në përfundimin e shqyrtimit të kërkesës.

b) Pezullimin e përkohshëm të masave të sigurisë dhe ekzekutimit të një të drejte të siguruar.

c) Caktimin e administratorit të përkohshëm të falimentit.

Gjykata konstaton se çështja hyn në juridiksionin gjyqësor dhe kompetente për gjykimin e saj është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

Nga gjykimi i çështjes rezultoi se:

Pala kërkuese, shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k., është shoqëri e së drejtës tregtare shqiptare, e regjistruar pranë QKR-së Tiranë më datë 18.9.1999 dhe me aktivitet të saj tregti me pakicë të mobilieve dhe aparateve të ndriçimit.

Administratorë të saj janë dy ortakët, Andi Koça dhe Artan Ziu nga data 17.5.2011 deri me datë 17.5.2016.

Me vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë datë 10.3.2014, është vendosur:



“1. Miratimi i çeljes së procedurës së falimentimit me riorganizim të shoqërisë, duke paraqitur kërkesën në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për këtë qëllim.

2. Ngarkohen administratorët të ndjekin procedurat ligjore duke autorizuar dhe përfaqësues për këtë qëllim.”

Mbas këtij vendimi pala kërkuese, shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k., ka paraqitur kërkesë para gjykatës, kolegjit tregtar.

Kërkesa e palës kërkuese bazohet në nenin 21 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin”, të ndryshuar me ligjet nr. 9919, datë 19.5.2008 dhe nr. 10137, datë 11.5.2009.

Neni 21 i ligjit shprehet:

“1. Derisa seksioni tregtar i gjykatës së rrethit gjyqësor të marrë vendim për kërkesën për hapjen e procedurës së falimentit, ai vendos mbi pasuritë e debitorit çdo lloj mase, që e gjykon të nevojshme për të shmangur përkeqësimin e gjendjes financiare të debitorit në dëm të kreditorëve.

2. Në mënyrë të veçantë, seksioni tregtar i gjykatës së rrethit:

a) mund të vendosë ndaj debitorit kufizim të përgjithshëm disponimi ose pranimi të shlyerjes së detyrimeve ose të urdhërojë që çdo disponim i pasurisë së tij të kryhet vetëm me miratimin përfundimtar të administratorit të përkohshëm;

b) mund të vendosë ndaj debitorit pezullim të përkohshëm të masave të sigurisë dhe të ekzekutimit të një të drejte të siguruar;

c) mund të emërojë një administrator të përkohshëm falimentimi.”

Rezulton se pala kërkuese ka lidhur këto kontrata kredie bankare:

1. Kontrata me nr. 1426 rep dhe nr. 1107 kol, datë 22.11.2004 të noteres Albana Hoti me Bankën Kombëtare të Greqisë për shumën prej 120.000 euro.

2. Kontrata me nr. 1424 rep dhe nr. 11.05 kol, datë 22.11.2004 me Bankën Kombëtare të Greqisë për shumën prej 50.000 euro.

3. Kontrata me nr. 394 rep dhe nr. 308/2 kol, datë 26.05.2010 me Bankën Kombëtare të Greqisë për shumën prej 19.000 euro.

4. Kontrata me nr. 593 rep dhe nr. 307/3 kol, datë 26.05.2010 me Bankën Kombëtare të Greqisë për shumën prej 410.413,57 euro.

5. Kontrata me nr. 592 rep dhe nr. 306/2 kol,

datë 26.5.2010 për shumën prej 200.000 euro me Bankën Kombëtare të Greqisë.

6. Kontrata me nr. 1425 rep dhe nr. 1106 kol, datë 22.11.2004 për shumën prej 50.000 euro me Bankën Kombëtare të Greqisë.

7. Kontrata me nr. 318 rep dhe nr. 210/2 datë 1.3.2006 për shumën prej 60.000 euro, me Bankën Kombëtare të Greqisë.

8. Kontrata me nr. 317 rep dhe nr. 209/2 kol, datë 1.3.2006 për shumën prej 60.000 euro, me Bankën Kombëtare të Greqisë.

9. Kontrata me nr. 9138 rep dhe nr. 3855 kol, datë 19.11.2008 për shumën prej 50.000 euro me Raiffeissen Bank.

10. Kontrata me nr. 9139 rep dhe nr. 3856 kol, datë 19.11.2008 për shumën prej 50.000 euro me Raiffeissen Bank.

11. Kontratë ristrukturim kredie datë 22.07.2010 për shumën prej 15.000 euro me Procredit Bank.

12. Kontratë ristrukturim kredie datë 23.4.2010 për shumën prej 25.000 euro me Procredit Bank.

Rezulton gjithashtu se kërkuesi, shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k., ka detyrime edhe ndaj:

1. Zyrës së Tatim-Taksave të Bashkisë Durrës 81.620 lekë.

2. Zyra Rajonale e Tatim-Taksave Durrës në shumën 3.420.318 lekë.

3. Kompanisë celulare “Vodafone” sh.a. 270.000 lekë.

4. Kompanisë celulare plus 91.836 lekë.

5. Kompanisë “CEZ Shpërndarje” 222.570 lekë.

Neni 1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 shprehet:

“1. Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyeje, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave, ose në rastin e një plani riorganizimi, nëpërmjet arritjes se një marrëveshje tjetër, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij.

2. Çdo debitori të ndershëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.”

Po kështu neni 13 i ligjit të mësipërm, përcakton se:

“1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak.”



Si shkaqe të fillimit të procedurave të falimentit, janë pikat 2, 3, 4, 5 të këtij neni, ku krahas paaftësisë paguese të debitorit, pamundësinë e tij për të paguar borxhet ose detyrimet e ardhshme janë detyrimet e tij të papaguara.

Në rastin konkret rezulton se kërkuësja, shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k., ka detyrime të konsiderueshme ndaj disa bankave dhe në pamundësi paguese ndaj tyre dhe kjo është reflektuar në faktin se ndaj saj, shoqëritë përmbartimore private kanë filluar ekzekutimin e detyrueshëm mbi pasuritë e saj, të cilat janë penguar me kontrata hipotekimi.

Kështu shoqëria përmbartimore “TDR Group” sh.p.k. ka filluar ekzekutimin në favor të Bankës Kombëtare të Greqisë, duke kryer disa veprime përmbartimore së sekuestrimit e disa pasurive, fillimin e procedurave të ankandit etj.

Po kështu shoqëria përmbartimore “Hoti Bailiff’s Service” ka filluar procedura për sekuestrimin e pasurive të palës kërkuese.

Ndodhur në këto rrethana konstatohet se pala kërkuese disponon këto pasuri në emër të saj dhe të ortakeve të saj:

1. Pasuria me nr. 26/160+1-21 ZK 8512, apartament në Durrës, në emër të ortakut Artan Ziu, me sipërfaqe 151 m².

2. Pasuria me nr. 26/160+1-22 ZK 8512, e ndodhur në Durrës, apartament 151 m² në emër të ortakut Andi Koça.

3. Pasuria me nr. 9/446 ZK 8513, në Durrës, truall me sipërfaqe 686 m² dhe ndërtesë 455 m² në emër të ortakut Artan Ziu.

Gjithashtu, pala kërkuese ka në pronësi të saj dhe të ortakeve të saj, këto pasuri të luajtshme:

1. Automjet, autoveturë tip “Ford” me targë DR 0904F, në emër të ortakut Artan Ziu.

2. Automjet tip “Daimler” me targë AA228BK, në pronësi të shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

3. Automjet tip “Mercedes Benz” me targë DR4640E në pronësi të shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

Gjykata, nisur nga kërkesa e paraqitur prej palës kërkuese, si dhe nga argumentet e paraqitura prej saj, bazuar në ligjin për falimentimin mendon se në këtë rast detyra e saj është mbrojtja e interesit të kreditorëve por ndërhyrja e saj vendimmarrëse, do të ketë për

qëllim edhe sigurimin e vazhdimësisë tregtare të kësaj shoqërie, përse ajo do të jetë e mundur në kushtet financiare, në të cilat ndodhet ajo.

Gjykata, me vendimin e saj datë 10.4.2014, ka vendosur:

“Të pranojë kërkesën e kërkuësit shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

2. Marrja e masës së sigurimit duke vendosur:

a) Kufizim të veprimeve pranë ZVRPP Durrës, për këto pasuri:

1. Pasuria me nr. 26/160+1-21 ZK 8512, apartament në Durrës, në emër të ortakut Artan Ziu, me sipërfaqe 151 m².

2. Pasuria me nr. 26/160+1-22 ZK 8512, e ndodhur në Durrës, apartament 151 m² në emër të ortakut Andi Koça.

3. Pasuria me nr. 9/446 ZK 8513, në Durrës, truall me sipërfaqe 686 m² dhe ndërtesë 455 m² në emër të ortakut Artan Ziu.

- Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor për këto automjete:

1. Automjet, autoveturë tip “Ford” me targë DR 0904F, në emër të ortakut Artan Ziu.

2. Automjet tip “Daimler” me targë AA228BK, në pronësi të shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

3. Automjet tip “Mercedes Benz” me targë DR4640E në pronësi të shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

- Pranë QKR mbi kuotat të shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

Moslejimin e tjetërsimit ose rëndimit me detyrime të këtyre pasurive dhe të kuotave deri në përfundimin e shqyrtimit të kërkesës.

b) Pezullimin e përkohshëm të masave të sigurisë dhe ekzekutimit të një të drejte të siguruar mbi këto pasuri, vendosur nga çdo organ tjetër.

c) Caktimi i administratorit të përkohshëm të falimentimit Robert Bega me adresë rr. Medar Shtylla”, nr. 48/1 Tiranë.

Kjo masë jepet me një afat 30-ditor, i cili fillon nga dita e sotme.”

Këtë vendim gjykata e rimori përsëri me vendimin e ndërmjetëm 21.05.2014, konform kjo nenit 21 të ligjit “Për falimentimin”.

Në vazhdim të gjykimit, gjykata, bazuar në nenin 22 të ligjit “Për falimentimin”:

“1. Në rast se seksioni tregtar i gjykatës së rrethit cakton një administrator të përkohshëm falimentimi dhe i heq debitorit të drejtën e disponimit të pasurisë, e drejta e administrimit dhe



e disponimit të pasurisë së debitorit i kalon administratorit të përkohshëm të falimentimit. Në këtë rast administratori i përkohshëm i falimentimit duhet:

a) të kujdeset për sigurimin dhe ruajtjen e pasurisë së debitorit;

b) të vazhdojë drejtimin e përditshëm të veprimtarisë së debitorit derisa seksioni tregtar i gjykatës së rrethit të vendosë për hapjen e procedurës së falimentimit, me përjashtim të rastit kur seksioni tregtar i gjykatës së rrethit miraton mbylljen e veprimtarisë për të shmangur humbje të mëtejshme të ndjeshme të pasurisë së debitorit;

c) të kryejë, si specialist, detyrat e caktuara në nenin 18 të këtij ligji.

2. Nëse seksioni tregtar i gjykatës së rrethit cakton një administrator të përkohshëm falimentimi pa i hequr të drejtën e përgjithshme të disponimit, gjykata i përcakton këtij administratori edhe detyra të tilla si mbikëqyrjen e veprimeve të debitorit. Gjithashtu, i kërkon administratorit të përkohshëm të falimentimit të vërë në dijeni gjykatën nëse janë të nevojshme masa të mëtejshme.

.....”

Gjykata, me vendimin e ndërmjetshëm të datës 5.5.2014, i dha të drejtën administratorit të falimentimit Robert Begaj, atë të administrimit, pa i hequr palës kërkuese shoqërisë “Mobil Eni”, të drejtën e disponimit.

Gjykata i caktoi si detyrë administratorit të përkohshëm të falimentimit që konform nenit 21 të ligjit “Për falimentimin” të përcaktonte:

1. Nëse vlera e barrëve siguroese është më e madhe se vlera e kredive të siguruara dhe e shpenzimeve të ekzekutimit të këtij detyrimi të marra së bashku.

2. Debitori, përpara përfundimit të afatit 30-ditor, paraqet para seksionit tregtar të gjykatës, prova të mjaftueshme për mundësinë e zbatimit të një plani riorganizimi, për realizimin e të cilit është thelbësor, përdorimi i barrëve siguroese.

Administratori i përkohshëm i falimentimit në parashtrimet e tij të datës 21.5.2014, arsyeton:

1. Lidhur me pikën e parë, administratori në tabelën që shoqëron parashtrimet e tij, arrin në përfundimin se vlera e barrëve siguroese e përballon vlerën e kredive të marra.

2. Pala debitore i paraqiti gjykatës dhe administratorit të përkohshëm të falimentimit një

“Plan riorganizimi”, në të cilën ajo argumenton se mund të dalë nga gjendja mospaguese financiare.

Megjithatë, nga ana e administratorit u përcaktua se ky plan organizimi duhet të ishte më i detajuar, për të arritur në një përfundim më të saktë, mbi daljen nga mospagesa financiare e palës kërkuese.

3. Në seancën e datës 11.6.2014, pala kërkuese e paraqiti planin e saj të riorganizimit më të detajuar. Nga administratori u vlerësua se ky plan i ri riorganizimi është më i plotë dhe me mundësi që pala kërkuese, të mund të riorganizoj aktivitetin e saj.

4. Kështu pala kërkuese paraqiti në vazhdim të planit të riorganizimit edhe “kontratë angazhim sipërmarrje” të datës 18.4.2014 me palë sipërmarrëse palën kërkuese shoqërinë “Mobil Eni” sh.p.k. dhe palë porositëse shoqërinë “Ermira” sh.p.k.

5. Sipas kësaj kontratë pala kërkuese merrte përsipër mobilimin e kompleksit të shërbimeve:

a) Mobilimin e 70 dhomave gjumi, me një vlerë totale 252.000 euro

b) Mobilim i hollit të hotelit, përfshirë dhe receptionin dhe vendin e pritjes 15.000 euro.

c) Mobilimin e restorantit me 40 tavolina me një vlerë totale 32.400 euro.

d) Mobilimi i sallës së konferencave dhe kinemasë, me vlerë 28.500 euro.

e) Mobilimi i 15 apartamenteve të të gjitha ambienteve me një vlerë 195.000 euro.

5. Në seancën e datës 11.6.2014, në të cilën u paraqit ky plan riorganizimi, administratori i përkohshëm i falimentit u shpreh se:

“Këto afate të reja bëhet më i plotë plani i organizimit dhe kemi terma për t’i kontrolluar në realizimin e tyre në kohë, duke arsyetuar se ky plan riorganizimi në kohë detajohet dhe të marrë jetë dhe mendoj se plani është i vlefshëm”.

6. Palët e treta kreditore kërkuar kohë lidhur me këtë plan riorganizimi dhe u shprehën dyshues lidhur me të.

7. Në seancën e sotme, të datës 16 qershor 2014, palët e treta u shprehen kundër planit të organizimit, pasi sipas tyre ky plan nuk është i detajuar dhe se nga ana e ortakëve janë vendosur hipotekë dhe mbi pronat e tyre personale dhe jo ato të shoqërisë.

8. Personi i tretë, Raiffeissen Bank, pretendoi se plani i paraqitur nga debitori nuk realist ose



nuk ka të ngjarë që të pranohet nga kreditorët, konform nenit 194/1 të ligjit “Për falimentimin”.

9. Gjykata, duke iu referuar nenit 182 të ligjit:

“Plani i riorganizimit përbëhet nga pjesa paraqitëse dhe analiza e hollësishme. Këtyre u shtohen dhe shtojcat e përmendura në nenet 229 dhe 230 të këtij ligji”.

10. Kurse neni 183 i ligjit shprehet:

“1. Në pjesën paraqitëse të planit të riorganizimit përshkruhen masat e marra pas fillimit të procedurës së falimentimit, për të krijuar bazat për tjetërsimin e të drejtave të palëve të përfshira.....”

10. Në rastin konkret, plani i riorganizimit i kërkuar nga gjykata është para hapjes së procedurës së falimentimit. Sipas kësaj dispozite, debitori mund të paraqesë dhe plan tjetër riorganizimi, pas hapjes së procedurës së falimentimit.

11. Dispozitat në vazhdim, të këtij ligji tregojnë se procedura e falimentimit është një proces në vazhdimësi, se kreditorët mund të bashkohen, të krijojnë komitetin e tyre dhe të kenë të drejtën e ballafaqimit me palën debitore.

12. Për rrjedhojë neni 194, të cilit i referohet pala e tretë, Raiffeissen Bank, ka të bëjë me mospranimin e planit të riorganizimit për pas hapjes së procedurës së falimentimit.

13. Zhvillimi i mëtejshëm i procedurës së falimentimit e drejton gjykata e falimentit dhe se kjo gjykatë është aktive në mbikëqyrjen e veprimtarive të palës debitore dhe është në korrent të vazhdueshëm të vendimeve që mund të marrin kreditorët, në rast se ata bashkohen, si dhe të verifikimit të ankesave të tyre si për debitorin, dhe për administratorin e falimentit. Kështu neni 224 e vijues i ligjit e përcakton qartë këtë detyrë të gjykatës.

14. Administratori i përkohshëm i falimentit shpjegoi se pikërisht plani i riorganizimit në këtë fazë nuk është shumë i detajuar. Detajimi i tij ndodh pas fillimit të procedurës së falimentit, ashtu si dhe në argumentum më lart, dhe që iu referuam dhe dispozitave të ligjit përkatës.

Gjykata pasi shqyrtoi gjithë dokumentacionin e paraqitur, arrin në përfundimin se kërkesa e palës kërkuese duhet të pranohet, pasi ajo u argumentua në përputhje me gjithë rrethanat financiare dhe tregtare të kësaj pale.

Nisur nga qëllimi i ligjit “Për falimentimin”, gjykata duhet të mbrojë jo vetëm interesat e

kreditorëve, por edhe të vetë palës debitore, në rast se kjo e fundit përcakton qartë e në mënyrë të detajuar planin e riorganizimit të saj, në mënyrë që të bëhet e besueshme jo vetëm për gjykatën, por dhe për vetë kreditorët se ajo do ta kalojë këtë vështirësi financiare dhe do të shlyejë detyrimet ndaj tyre.

Duke pranuar kërkesën e palës kërkuese, gjykata bazohet në nenet 9, 26, 27, 29 të ligjit “Për falimentimin”, i cili përcakton qartë detyrimet e secilës palë kreditore dhe debitore.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata pasi iu referua dhe nenit 9, 21, 22, 26, 27, 29, 141, 182, 183, 224, 233, 276 të ligjit nr. 8901, datë 25.3.2002, “Për falimentimin”, të ndryshuar,

VENDOSI:

Të pranojë kërkesën e kërkuesit shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k..

Hapjen e procedurës së falimentimit për palën kërkuese, shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k. me seli në Durrës, L.17 pranë Tregut Industrial, me objekt veprimtarie “Tregtia me pakicë e mobilieve dhe aparateve të ndriçimit”.

Të caktojë si administrator të falimentit Robert Begaj, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, rr. Medar Shtylla, 48/1.

Hapja e procedurës së falimentit u krye në ora 14 e 30’ të datës 16.6.2014.

Pala kërkuese shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k., si dhe kreditorët, palët e treta: Banka Kombëtare e Greqisë, Raiffeissen Bank, Procredit Bank, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, Drejtoria e Tatim-Taksave pranë Bashkisë Durrës, CEZ Shpërndarje, kompania “Vodafone” sh.a. duhet të paraqesin tek administratori i falimentit, pretendimet e tyre me shkrim, si dhe bashkëngjitur dokumentacionin përkatës.

Afati i paraqitjes së pretendimeve nga palët kreditore nuk mund të jenë jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë nga data e këtij vendimi.

Kreditorët e palës kërkuese duhet të zhvillojnë mbledhje për raportim më datë 11 shtator 2014, ora 10.00. Nga ana e administratorit të falimentit duhet të paraqitet një raport para kësaj mbledhje dhe t’u komunikohet palëve kreditore.



Pala kërkuese debitore shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k., duhet që detyrimet e saj t’ia paguajë administratorit të falimentit.

Urdhërohet QKR Tiranë të publikojë këtë vendim në internet, në faqen zyrtare të saj.

Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet personave të tretë, që janë në mungesë dhe janë kreditorë të palës kërkuese.

Një kopje e këtij vendimi t’i dërgohet ZQRPP Tiranë, të gjitha bankave të nivelit të dytë, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve Tiranë, Autoritetit Rrugor Kombëtar Tiranë.

Heqja e masës së sigurisë mbi pasuritë e palës kërkuese vendosur me vendimin e datës 21.5.2014.

Kundër vendimit lejohet ankim brenda 5 ditëve në Gjykatën e Apelit Durrës.

Për palët në mungesë ky afat fillon nga dita e nesërme e ditës së komunikimit të këtij vendimi.

U shpall në Durrës, në datë 16.6.2014

GJYQTARI
Petraq Çuri

VENDIM

Nr. 10-2015-588148, datë 12.3.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Apelit Durrës, e përbërë prej:

Kryesues: Agim Ferizaj

Anëtarë: Petrit Çeno

Anëtarë: Valentina Sadiraj

Asistuar nga sekretare Aida Demi, sot më datë 12.3.2015, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen civile që i përket:

PADITËS: Shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k.

I PADITUR: Qendra Kombëtare e Regjistrimit (QKR) Tiranë, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, Drejtoria Rajonale e Tatim-Taksave Durrës, Drejtoria e Tatim-Taksave Bashkia Durrës, Banka Kombëtare e Greqisë Raiffeissen Bank, Procredit Bank, "Cez Shpërndarje" sh.a. Durrës, kompania celulare “Vodafone” sh.a. Enkeljeda Ziu.

ME OBJEKT:

1. Deklarimin e fillimit të procedurave të falimentimit për riorganizimin e shoqërisë “Mobil Eni”.

2. Marrjen e masës së sigurimit të padisë duke

vendosur: Kufizim të veprimeve pranë ZVRPP Durrës, DPSHTRR dhe QKR mbi pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të kuotave të shoqërisë, moslejimin e tjetërsimit ose rendimin me detyrime të këtyre pasurive kuotave deri në përfundimin e shqyrtimit të kërkesës; Pezullimin e përkohshëm të masave të sigurisë dhe ekzekutimin e një të drejte të siguruar; Caktimin e administratorit të përkohshëm të falimentimit.

BAZA LIGJORE: Neni 334 e vijues i Kodit të Procedurës Civile, ligji nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” i ndryshuar.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. 958, datë 16.4.2014, ka vendosur:

- Të pranojë kërkesën e kërkuesit shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

- Hapjen e procedurës së falimentimit për palën kërkuese, shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k. me seli në Durrës, l. 17, Tregut Industrial me objekt veprimtarie: Tregtia me pakicë e mobilieve dhe aparateve të ndriçimit.

- Hapja e procedurës së falimentit u krye nga Robert Begaj, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, rruga “Meder Shtylla”, 48/1.

- Pala kërkuese, shoqëria "Mobil Eni" sh.p.k., si dhe kreditorët, palët e treta, Drejtoria Rajonale e Tatim-Taksave Durrës, Raiffeissen Bank, Procredit Bank “Cez Shpërndarje” sh.a. Durrës, kompania celulare “Vodafone” sh.a. duhet të paraqesin tek administratori i falimentit, pretendimet e tyre me shkrim, si dhe bashkëngjitur dokumentacionin përkatës.

- Afati i paraqitjes së pretendimeve nga palët kreditore nuk mund të jetë jo më pak se 15 ditë dhe jo më shumë se 90 ditë nga data e këtij vendimi.

- Kreditorët e palës kërkuese duhet të zhvillojnë mbledhjen për raportin e me datë 11 shtator 2014 ora 10.00. Nga ana e administratorit të falimentit duhet të paraqitet një raport para kësaj mbledhje dhe t’u komunikohet palëve kreditore.

- Pala kërkuese debitore shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k. duhet që detyrimet e saj t’ia paguajë administratorit të falimentit.

- Urdhërohet QKR Tiranë të publikojë këtë vendim në internet që janë në mungesë dhe janë kreditorë të palës kërkuese.



- Heqja e masës së sigurisë mbi pasuritë kërkuese vendosur me vendimin e datës 21.5.2014.

- Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pala e paditur Raiffeissen Banka duke parashtruar shkaqet për ndryshimin e tij si:

- Vendimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i bazuar në ligj e në prova e duhet të ndryshohet.

Gjykata e Apelit Durrës

Pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Agim Ferizaj, në mungesë të palëve të cilët janë njoftuar rregullisht e pasi shqyrtoi e bisedoi në tërësi çështjen,

VËREN:

Vendimi datë 16.6.2014 me nr. regj. 958 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës është i bazuar në ligj e në prova e si i tillë duhet të lihet në fuqi.

Siç rezulton nga materialet e ndodhura në dosjen gjyqësore, pala kërkuese i është drejtuar Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës me kërkesën e cituar më sipër.

Në gjykimin në shkallë të parë ka rezultuar se pala kërkuese shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k., është shoqëri e të drejtës tregtare shqiptare e regjistruar pranë QKR-së Tiranë me datë 18.9.1999 dhe me aktivitet të saj tregti me pakicë e mobilieve dhe aparateve të ndriçimit. Administratore të saj janë dy ortakët, Andi Koça e Artan Ziu nga data 17.5.2011 deri më datë 17.5.2016. Me vendimin e asamblesë së ortakëve të shoqërisë, datë 10.3.2014 është vendosur:

1. Miratimi i çeljes së procedurës së falimentimit me riorganizim të shoqërisë, duke paraqitur kërkesë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës për këtë qëllim.

2. Ngarkohen administratorët të ndjekin procedurat ligjore duke autorizuar dhe përfaqësues për këtë qëllim.

Pas këtij vendimi pala kërkuese shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k. ka paraqitur kërkesë para gjykatës, kolegjit tregtar. Kërkesa e palës kërkuese bazohet në nenin 21 të ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 “Për falimentimin” i ndryshuar me ligjet 9919, datë 19.5.2008 dhe nr. 10137, datë 11.5.2009.

Rezulton se pala kërkuese ka lidhur këto kontrata kredie bankare:

Kontrata me nr. 1426, rep dhe nr. 11 07 kol, datë 22.11.2004 me Bankën Kombëtare të Greqisë për shumën prej 120 000 euro.

Kontrata me nr. 1424 rep dhe nr. 1105 kol, datë 22.11.2004 me Bankën Kombëtare të Greqisë për shumën prej 50 000 euro.

Kontrata me nr. 394, rep dhe nr. 308/2 kol, datë 26.5.2010 me Bankën Kombëtare të Greqisë për shumën prej 19 000 euro.

Kontrata me nr. 593, rep dhe nr. 307/3 kol, datë 26.5.2010 me Bankën Kombëtare të Greqisë për shumën prej 410. 413,57 euro.

Kontrata me nr. 592, rep dhe nr. 306/2 kol, datë 26.5.2010 për shumën prej 200 000 euro me Bankën Kombëtare të Greqisë.

Kontrata me nr. 1425, rep dhe nr. 1106 kol, datë 22.11.2004 për shumën prej 50 000 euro me Bankën Kombëtare të Greqisë.

Kontrata me nr. 318 rep dhe nr. 210/2, datë 1.3.2006 për shumën prej 60 000 euro me Bankën Kombëtare të Greqisë.

Kontrata me nr. 317 rep dhe nr. 209/2 kol, datë 1.3.2006 për shumën prej 60 000 euro me Bankën Kombëtare të Greqisë.

Kontrata me nr. 9138 rep dhe nr. 3855 kol, datë 19.11.2008 për shumën prej 50 000 euro me Raiffessen Bank.

Kontrata me nr. 9139 rep dhe nr. 3856 kol, datë 19.11.2008 për shumën prej 50 000 euro me Raiffessen Bank.

Kontratë ristrukturim kredie datë 22.7.2010 për shumën prej 15 000 euro me Procredit Bank.

12. Kontrata ristrukturim redie datë 23.4.2010 për shumën prej 25 000 euro me Procredit Bank.

Rezulton gjithashtu se kërkuesi, shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k., ka detyrime edhe ndaj:

1. Zyrës së Tatim-Taksave të Bashkisë Durrës 81 620 lekë.

2. Zyra Rajonale e Tatim-Taksave Durrës në shumën 3 420 318 lekë.

3. Kompanisë celulare “Vodafone” sh.a. 270 000 lekë.

4. Kompanisë celulare lus 91 836 lekë.

5. Kompanisë “CEZ Shpërndarje” 222.570 lekë.

Neni 1 i ligjit nr. 8901, datë 23.5.2002 shprehet:

1. Procedura e falimentimit ka qëllim të shlyejë, në mënyrë kolektive, detyrimet e debitorit nëpërmjet likuidimit të të gjitha pasurive



të tij dhe shpërndarjes së të ardhurave, ose në rastin e një plani riorganizativ, nëpërmjet arritjes së një marrëveshjeje tjetër, me synim kryesor ruajtjen e veprimtarisë së tij.

2. Çdo debitori të ndershëm, nëpërmjet procedurës së falimentimit, i jepet mundësia të shkarkohet nga pjesa e mbetur e detyrimeve.

Po kështu neni 13 i ligjit të mësipërm, përcakton se: “1. Procedura e falimentimit hapet vetëm me shkak”.

Si shkaqe të fillimit të procedurave të falimentit, janë pikat 2, 3, 4, 5 të këtij neni, ku krahas paaftësisë paguese të debitorit, pamundësinë e tij për të paguar borxhet se detyrimet e ardhshme janë edhe detyrimet e tij të papaguara.

Në rastin konkret rezulton se kërkuesja shoqëria “Mobil Eni” sh.p.k. ka detyrime të konsiderueshme ndaj disa bankave dhe në pamundësi paguese ndaj tyre dhe kjo është reflektuar në faktin se ndaj saj, shoqëritë përbarimore private kanë filluar ekzekutimin e detyrueshëm mbi pasuritë e saj, të cilat janë të penguar me kontrata hipotekimi.

Kështu shoqëria përbarimore “TDR Grop” sh.p.k. ka filluar ekzekutimin në favor të Bankës Kombëtare të Greqisë, duke kryer disa veprime përbarimore si sekuestrimet e disa pasurive, fillimin e procedurave të ankandit etj.

Po kështu shoqëria përbarimore “Hoti Bailiff’s Service” ka filluar procedura për sekuestrimin e pasurive të palës kërkuese.

Ndodhur në këto rrethana, konstatohet se pala kërkuese disponon këto pasuri në emër të saj dhe të ortakëve të saj:

1. Pasuria me nr. 26/160+1-21 ZK 8512, apartament në Durrës, në emër të ortakut Artan Ziu, me sipërfaqe 151 m².

2. Pasuria me nr. 26/160+1-22 ZK 8512, e ndodhur në Durrës, apartament 151 m² në emër të ortakut Andi Koça.

3. Pasuria me nr. 9/446 ZK 8513, në Durrës trull me sipërfaqe 686 m² ndërtesë 455 m² në emër të ortakut Artan Ziu. Gjithashtu pala kërkuese ka në pronësi të saj edhe të ortakëve të saj këto pasuri të luajtshme:

1. Automjet, autoveturë tip “Ford” me targë Dr. 0904 F, në emër të ortakut Artan Ziu.

2. Automjet tip “Daimler” me targë AA 228 BK, në pronësi të shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

3. Automjet tip “Mercedez Benz” me targë DR 4640 E në pronësi të shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

Gjykata me vendimin e saj datë 10.4.2014 ka vendosur:

Të pranojë kërkesën e kërkuesit shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

2. Marrja e masës së sigurimit duke vendosur:

a) Kufizim të veprimeve pranë ZVRPP Durrës, për këto pasuri:

1. Pasuria me nr. 26/160+1-21 ZK 8512, apartament në Durrës në emër të ortakut Artan Ziu me sipërfaqe 151 m².

2. Pasuria nr. 26/160+1-22 ZK 8512, e ndodhur në Durrës, apartament 151 m² në emër të ortakut Andi Koça.

3. Pasuria me nr. 9/446 ZK 8513, në Durrës trull me sipërfaqe 686 m² dhe ndërtesë 455 m² në emër të ortakut Artan Ziu.

-Pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Transportit Rrugor për këto automjete:

1. Automjet autoveturë tip “Ford” me targë DR 0904 F, në emër të ortakut Artan Ziu.

2. Automjet tip “Daimler” me targë AA 228 BK, në pronësi të shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k..

3. Automjet tip “Mercedez Benz” me targë DR 4640 E në pronësi të shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k.

Pranë QKR mbi kuotat e shoqërisë “Mobil Eni” sh.p.k..

Moslejimin e tjetërsimit ose rendimin me detyrime të këtyre pasurive dhe të kuotave deri në përfundimin e shqyrtimit të kërkesës.

b) Pezullimin e përkohshëm të masave të sigurisë dhe ekzekutimit të një të drejte të siguruar mbi këto pasuri, vendosur nga çdo organ përbarimor ose çdo organ tjetër.

c) Caktimi i administratorit të përkohshëm të falimentimit Robert Bega me adresë rr. “Medar Shtylla” nr. 48/1 Tiranë.

Kjo masë jepet me afat 30-ditor i cili fillon nga dita e sotme.

Këtë vendim gjykata e ka rimarrë përsëri në vendimin e ndërmjetëm 21.5.2014, konform nenit 21 të ligjit “Për falimentimin”.

Në vazhdim të gjykimit, gjykata bazuar në nenin 22 të ligjit “Për falimentimin”, ku përcaktohet:

1. Në rast se seksioni tregtar i gjykatës së



rrethit cakton një administrator të përkohshëm të falimentit dhe i heq debitorit të drejtën e disponimit të pasurisë, e drejta e administrimit dhe e disponimit të pasurisë së debitorit i kalon administratorit të përkohshëm të falimentimit. Në këtë rast administratori i përkohshëm i falimentimit duhet:

a) të kujdeset për sigurimin dhe ruajtjen e pasurisë së debitorit;

b) të vazhdojë drejtimin e përditshëm të veprimtarisë së debitorit derisa seksioni tregtar i gjykatës së rrethit të vendosë për hapjen e procedurës së falimentimit, me përjashtim të rastit kur seksioni tregtar i gjykatës së rrethit miraton mbylljen e veprimtarisë për të shmangur humbje të mëtejshme të ndjeshme të pasurisë së debitorit;

c) të kryejë, si specialist, detyrat e caktuara në nenin 18 të këtij ligji.

2. Nëse seksioni tregtar i gjykatës së rrethit cakton një administrator të përkohshëm falimentimi pa i hequr të drejtën e përgjithshme të disponimit, gjykata i përcakton këtij administratori edhe detyra të tilla, si mbikëqyrjen e veprimeve të debitorit. Gjithashtu, i kërkon administratorit të përkohshëm të falimentimit të verë në dijeni gjykatën nëse janë të nevojshme masa të mëtejshme.

Gjykata me vendimin e ndërmjetëm të datës 5.5.2014, i ka dhënë të drejtën administratorit të falimentimit Robert Begaj, atë të administrimit, pa i hequr palës kërkuese shoqërisë “Mobil Eni”, të drejtën e disponimit.

Lidhur me pikën e parë, administratori në tabelën që shoqëron parashtrimin e tij, arrin në përfundimin se vlera e barreve siguroese e përballon vlerën e kredive të marra.

Pala debitore i ka paraqitur gjykatës dhe administratorit të përkohshëm të falimentimit një “Plan riorganizimi”, në të cilin ajo argumenton se mund të dalë nga gjendja mospaguese financiare.

Palët e treta kreditore kanë kërkuar kohë lidhur me këtë plan riorganizimi dhe kanë shprehur dyshimin e tyre lidhur me të.

Dispozitat në vazhdim, të këtij ligji, tregojnë se procedura e falimentimit është një proces në vazhdimësi, se kreditorët mund të bashkohen, të krijojnë komitetin e tyre dhe të kenë të drejtën e ballafaqimit me palën debitore.

Gjykata e shkallës së parë, në përfundim të

gjykimit, ka pranuar kërkesën e palës kërkuese si të bazuar në ligj e në prova.

Kundër vendimit të mësipërm është bërë ankim nga pala e paditur duke u pretenduar se vendimi i mësipërm nuk është i bazuar në ligj e në prova.

Gjykata e Apelit, pasi e shqyrtoi çështjen, çmon se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar në ligj e në provat e administruara në gjykimin në shkallë të parë e duhet të lihet në fuqi.

Gjykata e faktit, nisur nga kërkesa e paraqitur prej palës kërkuese, si dhe nga argumentet e paraqitura prej saj, bazuar në ligjin për falimentimin, ka vlerësuar se në këtë gjykim detyra e saj është mbrojtja e interesit të kreditorëve, por ndërhyrja e saj vendimmarrëse duhet të ketë për qëllim edhe sigurimin e vazhdimësisë tregtare të kësaj shoqërie, përse ajo do të jetë e mundur në kushtet financiare, në të cilat ndodhet ajo.

Nisur nga qëllimi i ligjit “Për falimentimin”, gjykata duhet të mbrojë jo vetëm interesat e kreditorëve, por edhe të vetë palës debitore, në rast se kjo e fundit përcakton qartë e në mënyrë të detajuar planin e riorganizimit të saj, në mënyrë të detajuar planin e riorganizimit të saj, në mënyrë që të bëhet e besueshme jo vetëm për gjykatën, por edhe për vetë kreditorët se ajo do ta kalojë këtë vështirësi financiare dhe do të shlyejë detyrimet ndaj tyre, gjë e cila është provuar në gjykimin e shkallës së parë.

Pala debitore i ka paraqitur gjykatës dhe administratorit të përkohshëm të falimentimit një “Plan riorganizimi”, në të cilin ajo argumenton se mund të dalë nga gjendja mospaguese financiare.

Në seancën e datës 11.6.2014, pala kërkuese e ka paraqitur planin e saj të riorganizimit më të detajuar. Nga administratori është vlerësuar se ky plan i riorganizimit është më i plotë dhe me mundësi që pala kërkuese, të mund të riorganizojë aktivitetin e saj.

Kështu pala kërkuese ka paraqitur në vazhdim të planit të riorganizimit edhe “Kontratë angazhimi sipërmarrjeje”, të datës 18.4.2014, me palë sipërmarrëse palën kërkuese shoqërinë “Mobil Eni” sh.p.k. dhe palë porositëve shoqërinë “Ermira” sh.p.k..

Sipas kësaj kontrate pala kërkuese merrte përsipër mobilimin e kompleksit të shërbimeve:



- mobilimin e 70 dhomave gjumi, me një vlerë totale 252 000 euro;

- mobilimin e hollit të hotelit, përfshirë edhe receptionin dhe vendin e pritjes, 15 000 euro;

- mobilimin e bar-restorantit me 40 tavolina, me një vlerë totale 32 400 euro;

- mobilimin e sallës së konferencave dhe kinemasë, me vlerë 28 500 euro;

- mobilimi i 15 apartamenteve të të gjitha ambienteve, 195 000 euro.

Gjykata e shkallës së parë është bazuar në nenet 9, 26, 27, 29 të ligjit “Për falimentimin”, i cili përcakton qartë detyrimet e secilës palë kreditore dhe debitore.

Në këto rrethana, Gjykata e Apelit çmon se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është i bazuar në ligj e në prova e duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata e Apelit Durrës, duke u bazuar në nenin 466/a të Kodit të Procedurës Civile,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit datë 16.6.2014 me nr. regj. 958 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Durrës, më datë 12.3.2015

Anëtarë: Agim Ferizaj (kryesues), Valentina Sadiraj, Petrit Çeno

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Tiranë, 2015